



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA PËR ZHVILLIM BUJQËSOR DHE RURAL
DREJTORIA JURIDIKE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Tiranë, më 30.7.2026

NJOFTIM PUNËSIMI

Bazuar në ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, në VKM nr. 719, datë 31.10.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural”, i ndryshuar, në Urdhrin e Kryeministrit nr. 93, datë 12.06.2024, “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural”, si dhe në përputhje me Urdhrin nr. 20, datë 19.01.2018, “Për krijimin e sporteleve unike të shërbimeve për fermerët-Agropika”,

Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural shpall njoftimin e punësimit për pozicionet vakante si mëposhtë vijon:

- **DREJTORIA E PËRZGJEDHJES DHE APROVIMIT TË PROJEKTEVE**
- **SPECIALIST INFO-APLIKIMI NË AGROPIKËN SHKODËR**

Detyrat kryesore të Specialistit Info-Aplikim janë:

- Të japë informacion dhe të promovojë programet e skemave mbështetëse kombëtare për bujqësinë dhe zhvillimin rural.
- Të japë informacion dhe të promovojë programet e skemave mbështetëse për bujqësinë dhe zhvillimin rural të financuar nga Bashkimi Evropian (IPARD), si dhe donatorë të tjerë.
- Të japë informacion mbi Fondet e Garancisë dhe lehtësirat financiare që ofrojnë tregjet bankare dhe financiare për fermerët.
- Të japë informacion mbi sektorin bujqësor dhe blegtoral.
- Të japë informacion mbi tregjet bujqësore dhe blegtorale.
- Të japë informacion mbi legjislacionin për bujqësinë, veterinarinë dhe sigurinë ushqimore.
- Të kryejë regjistrimin e të dhënave të fermës bujqësore dhe blegtorale sipas sistemeve të vëna në funksion.
- Të ofrojë asistencë teknike për aplikim për skemat kombëtare dhe Programin IPARD.
- Të bëjë pranimin e aplikimeve për mbështetjen financiare nga fondet e skemave kombëtare.
- Të bashkëpunojë me zyrat shtetërore, bashkitë, bankat, donatorët apo grupet e fermerëve, shoqatave për ofrimin e shërbimeve.
- Të raportojë pranë AZHBR qendër në mënyrë periodike.
- Të raportojë problematikat apo idetë dhe kërkesat e fermerëve.

➤ **Kandidatët e interesuar duhet të përmbushin këto kritere:**

1. Të kenë mbaruar Arsimin e Lartë Universitar, niveli Bachelor. (Diplomat e marra jashtë vendit duhet të jenë të njohura paraprakisht nga institucioni përgjegjës për njehësimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi).
2. Të kenë aftësi shumë të mira komunikuese.
3. Të kenë njohuri bazë në përdorimin e kompjuterit.
4. Të kenë njohuri bazë mbi zhvillimin bujqësor dhe rural në Shqipëri dhe mbi politikën e përbashkët për bujqësinë me BE-në.
5. Të kenë përvojë pune ose internshipi / praktika profesionale.

➤ **Kandidatët do të testohen në lidhje me:**

- Ligjin nr. 9817, datë 22.10.2007, “Për bujqësinë dhe zhvillimin rural”.
- Ligjin nr. 9367, datë 7.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar.
- Ligjin nr. 9131, datë 08.09.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”.
- VKM nr. 719, datë 31.10.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural”, i ndryshuar.

Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë brenda datës 4.8.2026, ora 16:30 në Agjencinë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (Adresa: Rruga “Muhamet Gjollështa”, Nr. 56, Tiranë): Kërkesën për punësim ku duhet të përcaktojnë pozicionin për të cilin po aplikojnë; një kopje të CV të përditësuar; diplomën e noterizuar; certifikata dhe kualifikime të ndryshme; një fotokopje e librezës së punës; një kopje të ID-së; formularin e vetëdeklarimit të gjendjes gjyqësore të firmosur nga aplikuesi; raportin mjeko-ligjor.

Të gjithë kandidatët që aplikojnë për pozicionet e mësipërme, do të marrin informacion vetëm në faqen e internetit të AZHBR www.azhbr.gov.al, për fazat e mëtejshme të kësaj procedure:

- për rezultatet e verifikimit
- datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurimi (testim me shkrim/ intervista me gojë)
- shpalljen e listës së fituesve

Për të marrë këto informacione, kandidatët duhet të vizitojnë në mënyrë të vazhdueshme faqen e internetit të AZHBR www.azhbr.gov.al.

AGJENCIA PËR ZHVILLIM BUIQËSOR DHE RURAL